



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 gusht 2019
Nr. Ref.:RK 1407/19

VENDIM PËR HEDHJE POSHTË TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI195/18

Parashtrues

Afrim Haxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PAKR. nr. 468/18
të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 14 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Afrim Haxha, nga Komuna e Mitrovicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [PAKR.nr.468/18] e 14 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [P.nr.120/2015] e 26 korrikut 2018 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore pretendon se i janë cenuar përmes Aktgjykimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një dokument një-faqësh të cilin e kishte emërtuar si "*Ankesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë*". Parashtruesi i kërkesës nuk kishte bashkëngjitur ndonjë dokumentacion mbështetës apo akt të autoriteteve publike.
7. Më 11 dhjetor 2018, Gjykata e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës që në rast se dëshiron të paraqes një rast për shqyrtim pranë Gjykatës, ai duhet të plotësojë formularin e Gjykatës ose ekuivalentin e tij, siç përcaktohet me nenin 22 të Ligjit dhe paragrafët (1) dhe (2) të rregullit 32 të Rregullores së punës, dhe të qartësojë se cilat të drejta apo liri themelore pretendon se iu janë shkelur dhe nga cili autoritet publik, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit. Gjykata po ashtu kërkoi nga ai që, në bazë të paragrafit 4 të nenit 22 të Ligjit dhe pikës (h) të paragrafit (2) të rregullit 32 të Rregullores së punës, të bashkëngjis dokumentet relevante.
8. Më 14 dhjetor 2018, përmes shërbimeve postare, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e plotësuar në Gjykatë së bashku me dokumentet mbështetëse.

9. Më 20 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
10. Më 17 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës së Apelit një kopje të kërkesës.
11. Më 13 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatë përmes së cilit e njoftoi Gjykatën si në vijim:

"[...] me një vendim të Gjykatës Supreme lënda është kthye në rivendosje në Gjykatë të Apelit, seanca mbahet me 26.02.2019.

Në një letër të mahershme të pranuar nga ju të nderuar keni kërkuar që të ju njoftojë. Deri te një vendim përfundimtar kërkoj nga Gjykata Kushtetuese të ma mbajë lëndën aktive."

12. Më 26 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatë të cilin ia kishte drejtuar Kryetares së Gjykatës. Të njëjtën shkresë ai ia kishte dorëzuar edhe disa krerëve të tjerë të institucioneve publike në Republikën e Kosovës. Nëpërmes kësaj shkrese, ai u ankua se e kishte pranuar një ftesë për seancë në gjuhën serbe dhe jo në gjuhën e tij amëtare, respektivisht gjuhën shqipe.
13. Më 23 korrik 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 26 korrik 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 120/2015], e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
15. Kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që Gjykata e Apelit, Aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin, përkatësisht, parashtruesin e kërkesës ta lirojë nga akuza në mungesë të provave.
16. Më 14 nëntor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 468/18] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
17. Në një datë të paspecifikuar, sipas informacioneve të dorëzuara nga vet parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme e ka shfuqizuar Aktgjykimin e kontestuar para kësaj Gjykate, respektivisht Aktgjykimin [PAKR. nr. 468/18] e 14 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit dhe e ka kthyer çështjen në rigjykim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk qartëson se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë cenuar përmes aktit të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimit [PAKR. nr. 468/18] të 14 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit, të cilin ai e konteston.
19. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se *“dëshmitë e tij nuk janë marrë parasysh”* dhe kërkon nga Gjykata që të vërtetojë *“a është përdorur ligji i vjetër apo i riu edhe a është parashkrue vjetërsue lënda”*.
20. Parashtruesi i kërkesës fillimisht ka kërkuar nga Gjykata që anulojë Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në lidhje me atë të Gjykatës Themelore dhe ta shpallë atë të pafajshëm. Megjithatë, me shkresën e 13 shkurtit 2019, përmes të cilës parashtruesi i kërkesës ka njoftuar Gjykatën që çështja e tij është kthyer sërish në Gjykatën e Apelit, ai kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij ta mbajë *“aktive”* deri në vendimmarrjen e radhës së Gjykatës së Apelit.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Në vlerësimin e përmbushjes së këtyre kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht vëren se bazuar në shkresat të cilat i ka dorëzuar në Gjykatë parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimi [PAKR.nr.468/18] i 14 nëntorit 2018 i Gjykatës së Apelit dhe të cilin parashtruesi i kërkesës e konteston para Gjykatës, është anuluar nga Gjykata Supreme dhe çështja e parashtruesit të kërkesës është kthyer në rigjykim në Gjykatën e Apelit.
24. Në rrethana të tilla, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse çështja para Gjykatës paraqet një pretendim aktiv dhe të diskutueshëm.
25. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës, dhe i cili përcakton:

Rregulli 35 i Rregullores së punës
[Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës]

“[...] (4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur Gjykata përcakton se pretendimi nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm [...]”.

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë duke kontestuar Aktgjykimin [PAKR. nr. 468/18] e 14 nëntorit 2018 të Gjykatës së Apelit, i cili kishte konfirmuar dënimin e tij me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të përcaktuar nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.120/2015] të 26 korrikut 2018. Më vonë, dhe siç është theksuar më lart, sipas njoftimeve të dorëzuara në Gjykatë nga vet parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme ka prishur Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe e ka kthyer çështjen në rivendosje tek kjo e fundit. Për rrjedhojë, Aktgjykimi i kontestuar para kësaj Gjykate nuk është më tej në fuqi dhe si i tillë, nuk prodhon asnjë efekt juridik për parashtruesin e kërkesës.
27. Duke qenë kështu, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, përbëjnë pretendime të cilat tanimë nuk janë *“aktive të diskutueshme”*. Andaj, në përputhje me paragrafin (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, duhet të hudhet poshtë si e papranueshme për shqyrtim të mëtejshme.
28. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata që ta mbajë kërkesën e tij *“aktive”* deri sa të arrihet një *“vendim përfundimtar”* lidhur me rastin e tij.
29. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se kërkesat në Gjykatë nuk mund të mbahen aktive, siç kërkon parashtruesi i kërkesës, meqë nuk ka asnjë bazë ligjore në bazë të së cilës një gjë e tillë mund t'i kërkohej Gjykatës apo në bazë të së cilës i lejohet Gjykatës të miratojë të tilla kërkesa.
30. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se përfundimi i dhënë këtu nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës që në një fazë të mëvonshme t'i drejtohet Gjykatës sërish duke kontestuar një akt të një autoriteti publik i cili ai pretendon se i shkel të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës.
31. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit duhet të hudhet poshtë në bazë të paragrafit (4) të rregullit 35 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 35 (4) të Rregullores së punës, më 23 korrik 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË HUDHË poshtë kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi